

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“NLA GROUP” Sh.p.k**

**I.      THEMELIMI**

**NENI 1  
Ortaket themelues**

Shoqeria krijohet nga ortaku themelues:

- Z. Amir Ilazi, shtetas maqedonas, lindur me 08/12/1988 ne Gostivar, Maqedoni, identifikuar me pasaportën maqedonase nr. H0428667, madhor e me zotesi te plote per te vepruar..

**II.     EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE - OBJEKTI**

**NENI 2  
Emertimi**

Shoqeria emerthet “**NLA GROUP**”

**NENI 3  
Forma juridike**

Forma juridike do te jetë shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per shoqerite Tregtare”.

**NENI 4  
Selia**

4.1 Shoqeria “NLA GROUP” Sh.p.k e ka seline e saj ne adresen: Tirane Rruga “Teodor Keko” Ndertesa Nr. 36.

4.2 Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqerise dhe do te veprojne nen mbikqyrjen e Administratorit të “NLA GROUP” Sh.p.k.

**NENI 5  
Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

- 5.1. Shoqëria “NLA GROUP” Sh.p.k ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
- 5.2. Veprimtaria e Shoqërisë “NLA GROUP” Sh.p.k, do të ketë për objekt:

Shërbime marketingu, reklamimi, shërbime konsulence në fushën e marketingut, teknologjise se informacionit dhe komunikimit, burimeve njerezore, ekonomike, financiare, te biznesit dhe

investimeve, te marketingut, te promovimit, studimeve te tregut, ne fushen e kerkimit dhe botimit shkencor.

5.2.2 Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter që është në përputhje me legjisacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislativi në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;

5.2.3 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

5.3 Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese se Pergjithshme.

### **III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA**

#### **NENI 6 Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

#### **NENI 7 Kapitali i Shoqerise**

7.1 Kapitali themeltar i shoqerise "NLA GROUP" Sh.p.k perfaqesohet nga 1 (nje) kuote me vlore 100.000 (njeqind mijë) Leke dhe nuk eshte paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:

- Z. Amir Ilazi: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme 100.000 (njeqind mijë) Leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### **NENI 8 Asambleja e Pergjithshme**

Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet qe ligji apo Statuti ia rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Pergjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje register te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise "NLA GROUP" Sh.p.k.

8.2 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- ndryshimit të Statutit;
- riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likujdimi, shnderrimi i shoqerise;
- zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre;
- emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose Statuti jepin shprehimisht Asamblese

#### **NENI 9 Organet drejtuese**

9.1. Organet drejtuese të Shoqerisë janë:



- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të paqisur më prokurë të veçantë; dhe  
b) Administratori

**NENI 10**  
**Administratori i Shoqërisë**

- 10.1 Shoqeria administrohet nga Administratori, një person fizik që mund te jetë ose jo ortak i Shoqerise.  
10.2 Administratori është i detyruar të drejtojë Shoqerinë në përputhje me ligjin "Për tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", Statutin, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.  
10.3 Administratori i Shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje ne detyre per një kohë prej 5 (pese) vjetesh.  
10.4 Administratori i pare i shoqerise emerohet Z. Amir Ilazi, shtetas maqedonas, lindur me 08/12/1988 ne Gostivar, Maqedoni, identifikuar me pasaportën maqedonase nr. H0428667, madhor e me zotesi te plete per te vepruar..

Nenshkrimi i administratorit



- 14.4 Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

**NENI 11**  
**Ligji i zbatueshem dhe mosmarreveshjet**

- 11.1 Per sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i behet legjislacionit shqiptar ne fuqi.  
11.2. Per te gjitha mosmarreveshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi komponent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.  
11.3. Ky dokument redaktohet ne 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kupuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaku themelues

**ORTAKU THEMELUES**

Z. Amir Ilazi



Data: 13.03.2019